



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:244681
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05384966

C.nr.3885/2023

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen juridiko- kontestimore të paditësve: **B.S.** numër personal nga Prizreni, **F.P.** me numër personal nga Prizreni, **V.B.** me numër personal nga Prizreni, **Sh.B.** me numër personal nga Prizreni, **A.H.** me numër personal nga Prizreni, **E.K.** me numër personal nga Prizreni, **B.T.** me numër personal nga fshati komuna e Prizrenit; **S.H.** me numër personal nga Prizreni, **J.T.** me numër personal nga Prizreni, dhe **S.K.** me numër personal nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. M.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurës Spitali i përgjithshëm “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të (trembëdhjetë), vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë seancës, më datë 28.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve B.S., F.P., V.B., Sh.B., A.H., E.K., B.T., S.H., J.T., dhe S.K. që të gjithë nga Prizreni, “me të cilën kanë kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar dhe të detyrohet e paditura Spitali i përgjithshëm “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren: që **1. B.S.** në emër të kompensimit të pagave të 13-ta (trembëdhjeta), për vitet 2018, një pagë bazë (377), për vitin 2019 një pagë bazë (377) dhe për vitin 2020 një pagë bazë (377) t’ia paguajë shumën prej 1,131.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së kësaj padie, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, **2.F.P.** në emër të kompensimit të pagave të 13-ta (trembëdhjeta), për vitet 2018, një pagë bazë (471), për vitin 2019 një pagë bazë (471) dhe për vitin 2020 një pagë bazë (471) t’ia paguajë shumën prej 1,413.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së kësaj padie, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. **3. V.B.** në emër të kompensimit të pagave të 13-ta (trembëdhjeta), për vitet 2018, një pagë bazë (377), për vitin 2019 një pagë bazë (377) dhe për vitin 2020 një pagë bazë (377) t’ia paguajë shumën prej 1,131.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së kësaj padie, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. **4.Sh.B.** në emër të kompensimit të pagave të 13-ta (trembëdhjeta), për vitet 2018, një pagë bazë (377), për vitin 2019 një pagë bazë (377) dhe për vitin 2020 një pagë bazë (377) t’ia paguajë shumën prej 1,131.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së kësaj padie, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. **5.A.H.** në emër të kompensimit të pagave të 13-ta (trembëdhjeta), për vitet 2018, një pagë bazë (377), për vitin

2019 një pagë bazë (377) dhe për vitin 2020 një pagë bazë (377) t'ia paguajë shumën prej 1,131.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së kësaj padie, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, **6.E.K.** në emër të kompensimit të pagave të 13-ta (trembëdhjeta), për vitet 2018, një pagë bazë (377), për vitin 2019 një pagë bazë (377) dhe për vitin 2020 një pagë bazë (377) t'ia paguajë shumën prej 1,131.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së kësaj padie, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, **7.B.T.** në emër të kompensimit të pagave të 13-ta (trembëdhjeta), për vitet 2018, një pagë bazë (314), për vitin 2019 një pagë bazë (314) dhe për vitin 2020 një pagë bazë (314) t'ia paguajë shumën prej 942.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së kësaj padie, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, **8.S.H.** në emër të kompensimit të pagave të 13-ta (trembëdhjeta), për vitet 2018, një pagë bazë (314), për vitin 2019 një pagë bazë (314) dhe për vitin 2020 një pagë bazë (314) t'ia paguajë shumën prej 942.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së kësaj padie, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, **9.J.T.** në emër të kompensimit të pagave të 13-ta (trembëdhjeta), për vitet 2018, një pagë bazë (314), për vitin 2019 një pagë bazë (314) dhe për vitin 2020 një pagë bazë (314) t'ia paguajë shumën prej 942.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së kësaj padie, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, **10.S.K.** në emër të kompensimit të pagave të 13-ta (trembëdhjeta), për vitet 2018, një pagë bazë (659), për vitin 2019 një pagë bazë (659) dhe për vitin një pagë bazë (659) t'ia paguajë shumën prej 1,977.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së kësaj padie, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Ar sy e t i m

Paditësit B.S., F.P., V.B., Sh.B., A.H., E.K., B.T., S.H., J.T., dhe S.K. të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. M.Sh. nga Prizreni, kanë paraqitur padi kundër te paditurës, Spitali përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të (trembëdhjetë), për periudhën 2019, 2020 dhe 2021. Ndërsa me parashtresën për precizimin e padisë, dorëzuar në gjykatë, më datë 15.12.2023, paditësit kanë kërkuar kompensimi e pagës së 13-të (trembëdhjetë), për periudhën 2018, 2019 dhe 2020.

Në padi, i autorizuarit i paditësve ka theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura e sistemuar në punët dhe detyrat e punës për periudha të ndryshme kohore, e në veçanti për periudhën kur kërkohet kompensimi i pagës së 13-të (trembëdhjetë) për vitet 2019, 2020 dhe 2021. Duke marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale më konkretisht nenin 17 par. 2, e paditura nuk ka bërë kompensimin e pagës së 13-të (trembëdhjetë) për vitet 2019, 2020 dhe 2021. Pasi që të paditurit nuk e ka përmbushur obligimin sipas dispozitave ligjore të lartcekur, i është drejtuar gjykatës me qëllim që të detyrohet e paditura, që paditësve t'ia kompensojnë pagën e 13-të për vitet 2018, 2019 dhe 2020, si në shumat e përcaktuara në parashtresën për precizimin e padisë datë 15.12.2023. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura me datë 22.02.2024, ka paraqitur përgjigje në padi, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar. Duke theksuar se kërkesëpadija e paditësve është e pa bazuar për kompensimin e pagave të 13-të (trembëdhjetë) pasi që paditësit kërkesën e bazojnë në nenin 17 par. 2 të kontratës kolektive sektoriale. Ndërsa, kontrata kolektive sektoriale nuk e obligon punëdhënësin, që të bëjë kompensimin e pagave të 13-ta, por në bazë të mundësive buxhetore. Mirëpo një kërkesë e tillë është e pabazuar, pasi që nuk kanë mundësi buxhetore për një gjë të tillë, për shkak mjeteve të kufizuara buxhetore. Në këtë drejtim, me njoftimin nr. prot. 3823 të datës 21.12.2023, ka njoftuar gjykatën se që nga viti 2018 e deri në vitin 2022, nuk kanë pasur mundësi buxhetore që të përmbushin nevojat në paga dhe mëditje ku kanë pasur deficit në paga dhe e ka plotësuar ministria e Financave për mbulimin e pagave të rregullta. Andaj, ka propozuar që kërkesëpadija e paditësve të refuzohet si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e refuzoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Spitalin Përgjithshëm “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren.

Kontestuese në mes palëve ishte nëse paditësve ju takon e drejta për kompensimin e pagës së 13-të (trembëdhjetë).

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri më datë 10.06.2021. Me nenin 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, është paraparë se “punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13-të (trembëdhjetë), për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”.

Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, përcaktohet në mënyrë shprehimore se çështja e kompensimit të pagës së 13-të (trembëdhjetë) për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, respektivisht nëse ka mjete buxhetore. Pra, e drejta e punëmarrësit (paditësve) për të realizuar pagën e 13-të (trembëdhjetë), krijohet kur punëdhënësi (e paditura) nuk e përmbushë atë, ndërsa nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Në fund, është në barrën e punëdhënësit që të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e një kërkesë të tillë.

Së këndejmi, me njoftimin nr. prot. 3823 të datës 21.12.2023, e paditura në mënyrë konkrete dhe të detajuar ka ilustruar të dhënat se që nga viti 2018 e deri në vitin 2022, nuk ka pasur mundësi buxhetore për të realizuar pagën e 13-të (trembëdhjetë) për punëtorët (paditësit).

Andaj, gjykata vlerëson se dispozita ligjore e nenit 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, nuk është e karakterit detyrues për palët kontraktuese. Kështu, duke u mbështetur edhe në mendimin juridik nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, duke qenë se të provuarit e faktit nëse ka mundësi buxhetore i ka takuar të paditurës, e njëjta me njoftimin nr. prot. 3823 të datës 21.12.2023, ka provuar se nuk ka mundësi buxhetore për të kompensuar pagën e 13-të (trembëdhjetë) ndaj paditësit. Kësisoj, gjykata duke vlerësuar bazën

ligjore të theksuar më lartë dhe gjendjen faktike të vërtetuar, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet refuzuar si e pabazuar. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia e paditësit, qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe në bazën juridike konkrete.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 par. 1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”. Ndërsa në paragrafin 2 të nenit të lartcekur është paraparë se “kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në nenin 450, 452 të LPK-së. Pra, përkundër faktit se paditësit i kanë kërkuar shpenzimet procedurale, kërkesëpadia e tyre ishte e pabazuar dhe kështu kanë humbur kontestin në këtë procedurë gjyqësore. Në anën tjetër, përkundër faktit se e paditura ka fituar kontestin, e njëjta nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.3885/2023 të datës 28.02.2024

Gjyqtari

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.